



Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave



Shërbimi Kombëtar
i Punësimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 474 / Prot., datë 19.11.2018
16

SHËRBIMI KOMBËTAR I
PUNËSIMIT

Nr. 384 / Prot., datë 19.11.2018
11

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Midis

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
në vijim referuar si "INSTAT" dhe

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT
Në vijim referuar si "SHKP"

1. QËLLIMI

Ky Memorandum Mirëkuptimi rregullon marrëdhënien midis Institutit të Statistikave si koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor dhe prodhuesi kryesor zyrtar i statistikave në Shqipëri (në vijim referuar “INSTAT”) dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (në vijim referuar “SHKP”), duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë për hartimin, shpërndarjen, transmetimin, shkëmbimin e të dhënave si dhe fushat dhe kushtet e bashkëpunimit për prodhimin e statistikave zyrtare kombëtare nën Programin e Statistikave Zyrtare.

Ky Memorandum mbështetet në Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” (në vijim referuar “Ligji i Statistikave”), vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.10/2017, datë 09.02.2017 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017 –2021”.

INSTAT është institucioni përgjegjës për të siguruar që statistikën janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas parimeve të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, i ndryshuar (në vijim referuar “Ligji i statistikave”;

Neni 13, pika 2 (ë) e ligjit të statistikave parashikon që INSTAT mund të hartojë, negociojë e të nënshkruajë memorandume mirëkuptimi me të gjitha agjencitë statistikore dhe me mbajtësit e të dhënave administrative, duke përfshirë organizimet e punës dhe detyrimet e palëve;

Neni 13, pika 1 (ç) e ligjit të statistikave INSTAT duhet të marrë pjesë në proceset e krijimit dhe zhvillimit të sistemeve të të dhënave administrative, për tu përdorur për qëllime statistikore;

Neni 25, pika 8 e ligjit të statistikave detyron të gjitha institucionet publike të njoftojnë INSTAT-in për çdo projektakt të propozuar për miratim në Këshillin e Ministrave apo Kuvend, i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në veprimtarinë statistikore që ushtrohet në Republikën e Shqipërisë;

Neni 33, pikat 1 e ligjit të statistikave parashikon që të gjitha institucionet qendrore dhe vendore i japin INSTAT-it të drejtën e hyrjes pa pagesë në regjistrat, skedarët e të dhënave dhe të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura, sipas përgjegjësive përkatëse, në masën që është e nevojshme për nxjerrjen e statistikave, duke shmangur ngarkesat në përgjigje për njësitë statistikore;

Neni 33, pikat 2 e ligjit të statistikave detyron institucionet publike të informojnë INSTAT-in për krijimin e çdo dokumentacioni të ri me të dhëna administrative apo për ndryshimin e atyre ekzistuese;

Neni 31 i ligjit të statistikave detyron INSTAT-in të trajtojë si konfidenciale çdo të dhënë të mbledhur, përpunuar dhe ruajtur për nxjerrjen e statistikave zyrtare;

Neni 40, pika 1 e ligjit të statistikave parashikon që ky ligj prevalon ndaj çdo dispozite të parashikuar në

ligje të tjera, në bazë të të cilave ushtrojnë veprimtarinë institucionet publike, gjë që bëhet pengesë për dhënien dhe transmetimin e të dhënave administrative për qëllime statistikore ose për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të mbledhura vetëm për qëllime statistikore;

Duke patur parasysh që:

- Sistemi Kombëtar Statistikor bazohet në një bashkëpunim të ngushtë mes INSTAT-it nga njëra anë dhe agjencive të tjera statistikore dhe mbajtësve të të dhënave administrative nga ana tjetër;

- Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka si mision përmbushjen e të drejtës së të gjithë shtetasve rezidentë në Shqipëri për formimin profesional, riaftësimin për punë, dhe për punësim fitimprurës nëpërmjet shërbimeve të punësimit dhe pjesëmarrjes në programet shtetërore të tregut të punës.

Instituti i Statistikave dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit bien dakort të nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit si vijon:

2. OBJEKTI

Ligji i statistikave i jep kompetencë të plotë INSTAT-it të prodhojë pjesën kryesore të statistikave zyrtare si dhe të monitorojë veprimtarinë statistikore të agjencive statistikore dhe institucioneve të tjera që disponojnë, krijojnë, përditësojnë dhe mirëmbajnë të dhënat administrative, në interes të zbatimit të Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare.

Memorandumi i Mirëkuptimit synon të rrisë performancën e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, duke rregulluar mënyrën e organizimit të punës, transmetimit të të dhënave si dhe detyrimet e ndërsjella të institucioneve nënshkruese në kuadër të këtij bashkëpunimi.

- (1) Programi pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare, më i fundit i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 10/2017 datë 09.02.2017, përfshin periudhën 2017-2021, përcakton institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, si dhe afatet kohore për kryerjen e aktiviteteve statistikore.
- (2) Në vijim të eksperiencës bashkëpunuese ndër vite, INSTAT dhe SHKP do të vazhdojnë bashkëpunimin e mirë në fushën statistikore me qëllim që të përmirësojnë cilësinë e prodhimit statistikor në përputhje me parimet e statistikave zyrtare, me qëllim që t'i përgjigjen në kohë dhe mënyrën e përshtatshme kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për informacion statistikor.

3. PAVARËSIA PROFESIONALE

- (1) Në mbështetje të Nenit 4 të Ligjit të statistikave, INSTAT, agjencitë statistikore dhe institucionet që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna administrative dhe statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Për këtë qëllim, SHKP merr përsipër të zbatojë parimet e besueshmërisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të të dhënave statistikore. SHKP

ndërmerr veprime kundër çdo përpjekje për influencim nga autoritete të tjera, vendase apo të huaja, dhe informon INSTAT-in.

- (2) SHKP garanton disponibilitetin e burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky Memorandum Mirëkuptimi si dhe ndërmerr veprimtari të tjera që ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor brenda institucionit.

4. GRUPI I PUNËS

- (1) Me qëllim që të sigurohet zbatimi i këtij Memorandumi, brenda një muaji nga data e nënshkrimit të tij krijohet një grup pune përgjegjës për të koordinuar aktivitetet e palëve.

- (2) **Grupi i Punës:**

- A- Përbëhet nga të paktën 4 anëtarë të zgjedhur me konsensusin e titullarëve të institucioneve, duke siguruar pjesëmarrje të barabartë mes palëve;
- B- Kryesohet nga një përfaqësues i INSTAT-it, anëtar i Grupit të Punës;
- C- Mblidhet të paktën çdo tre muaj ose kur kërkohet nga njëra palë;
- D- Mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhje ekspertë teknikë ose funksionarë të tjerë që kanë lidhje apo mund të japin mendim për çështje të ndryshme brenda objektit të punës;

- (3) **Grupi i punës ka këto detyra:**

- A- Monitoron zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara duke verifikuar në çdo fazë përputhjen mes objektivave dhe rezultateve të arritura;
- B- Tërheq vëmendjen për vonesat në shkëmbimin e informacionit apo keqfunksionimin e zbatimit të detyrave;
- C- Përcakton shkaqet dhe pengesat që ndalojnë arritjen e plotë të rezultateve të pritshme;
- D- Paraqet propozime për zgjidhjen e problemeve, duke përfshirë edhe ato për modifikimet e mundshme të Memorandumit dhe anekseve pjesë integrale të tij, dhe ia paraqet për miratim institucioneve, sipas të njëjtës procedurë që ndiqet për nënshkrimin e këtij memorandumi;
- E- Propozon iniciativa specifike për rritjen profesionale të statistikienëve nëpërmjet kurseve të trajnimit, pjesëmarrjes në takime pune me organizatat partnere brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrjes në konferenca, seminare dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet me prodhimin statistikor;
- F- Propozon fillimin e projekteve kërkimore dhe studimore në sektorë të veçantë të interesit të përbashkët;
- G- Ndërmerr iniciativa për të mbështetur zbatimin korrekt të të drejtës së shkëmbimit të të dhënave.

5. UDHËZIMET PËR STANDARTET PROFESIONALE

- (1) INSTAT detyrohet të vendosë në statistikën zyrtare të gjitha përkufizimet statistikore, klasifikimet dhe nomenklaturat, në përputhje me konceptet dhe klasifikimet ndërkombëtare, aty

ku është e mundur (Neni 14, pika 2 (e) e ligjit të statistikave).

- (2) Udhëzimet dhe aktivitetet e parashikuara në zbatim të tyre në lidhje me kërkesat e këtij memorandumi propozohen nga Grupi i punës, dhe sipas pikës 3 seksioni 4 të Memorandumi, miratohen me mirëkuptimin e palëve.
- (3) SHKP siguron që puna për prodhimin e statistikave nën autoritetin e saj do të kryhet në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga INSTAT.

6. E DREJTA E HYRJES DHE SHKËMBIMI I TË DHËNAVE

- (1) Për prodhimin e statistikave zyrtare sipas Programit pesëvjeçar, SHKP bën zhvillimet e duhura për gjenerimin e të gjitha raporteve të rëna dakort midis palëve sipas anekseve pjesë përbërëse e këtij Memorandumi. Këto raporte do të dërgohen zyrtarisht në formë elektronike sipas afateve të rëna dakort midis palëve në anekset bashkëngjitur këtij Memorandumi. Raportet do të transmetohen me shkresë dhe elektronikisht on-line (me email) në kohë reale për INSTAT-in në momentin që ky i fundit do të ndërtojë infrastrukturën me kapacitetet e nevojshme elektronike për administrimin e të dhënave.
- (2) Të dhënat që shkëmbehen, forma dhe periodiciteti i transmetimit përcaktohen në mënyrë të detajuar në Aneksin pjesë përbërëse të këtij Memorandumi.
- (3) Transmetimi i të dhënave kryhet pa pagesë.
- (4) INSTAT garanton mbështetjen teknike dhe metodologjike për zbatimin e duhur të Memorandumi.
- (5) Të dhënat e transmetuara nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit tek Instituti i Statistikave trajtohen si të dhëna konfidenciale dhe administrohen duke respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat e parashikuara në Nenin 31 “Konfidencialiteti” i ligjit të statistikave.

7. SIGURIMI I ZBATIMIT TË PËRSHTATSHËM TË PROGRAMIT

- (1) INSTAT është institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor.
- (2) INSTAT është përgjegjës për zbatimin e përshtatshëm të Programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare dhe raportimin e ecurisë së tij para Kuvendit.
- (3) INSTAT është i detyruar të organizojë dhe kryesojë takime të zgjeruara këshillimore me drejtuesit e strukturave që ndjekin çështjet statistikore, në Ministri dhe në Agjencitë e tjera Statistikore, për çështje të interesave profesionale dhe për realizimin e programit, problemet dhe veprimet e nevojshme për përmirësimin e tij.

8. MODULET ADMINISTRATIVE ME INTERES STATISTIKOR

- (1) Me qëllim që të rrisë përdorimin statistikor të të dhënave administrative, SHKP bie dakort me INSTAT-in që, nëpërmjet Grupit të Punës të ngritur sipas Seksionit 4 të këtij Memorandumi, të

modifikojë, integrojë dhe dizenojë formularët që përmbajnë informacion statistikor, duke siguruar që përkufizimet dhe klasifikimet përkatëse të jenë në përputhje me ato të përdorura nga INSTAT dhe i gjithë Sistemi Kombëtar Statistikor.

- (2) Për të realizuar kërkesat e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të Seksionit 7, palët nënshkruese të Memorandumit e rregullojnë bashkëpunimin e tyre si më poshtë:
 - a) SHKP njofton INSTAT për çdo vërtetim statistikor i cili parashikohet të kryhet nga kjo agjenci apo nga çdo institucion tjetër nën përgjegjësinë e saj. INSTAT jep opinionin e tij për projektin brenda gjashtë javëve. Nëse nuk jepet një përgjigje brenda këtij afati, projekti konsiderohet i miratuar.
 - b) Procedurat për prodhimin e statistikave të zbatuara nga SHKP apo nga ndonjë institucion tjetër të varësisë, shqyrtohen nga INSTAT. Për të plotësuar këtë detyrim, INSTAT-it i jepet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm statistikor. INSTAT merr përsipër të specifikojë informacionin që kërkon brenda një afati të arsyeshëm, ndërsa SHKP i transmeton të dhënat në kohë dhe formën e kërkuar nga INSTAT duke respektuar legjislacionin në fuqi.
 - c) Me kërkesë të INSTAT-it, SHKP jep informacion mbi përparimin e bërë lidhur me detyrat e vendosura në Programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare.
 - ç) SHKP njofton dhe merr mendim paraprakisht nga INSTAT-i për çdo akt ligjor ose nënligjor i cili i propozohet për miratim Kuvendit ose Këshilli i Ministrave dhe që mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në aktivitetet statistikore që kryhen në Republikën e Shqipërisë.
- (3) Palët bien dakort të bëjnë përpjekje për minimizimin e barrës raportuese, duke lejuar shkëmbimin e nevojshëm të informacionit, të dhënave administrative dhe burimeve të tjera të disponuara nga secila palë, përfshirë shkëmbimin e informacionit konfidencial statistikor, në masën e nevojshme dhe vetëm për qëllime të prodhimit të statistikave zyrtare, sipas përcaktimeve në legjislacionin kombëtar.
- (4) Secila palë bie dakort të marrë parasysh nevojat e palëve të tjera në hartimin e formularëve për mbledhjen e informacionit statistikor nga agjentët e saj raportues sipas anekseve bashkëngjitur.
- (5) Secila palë duhet të konsultohet me palën tjetër para formalizimit të një formulari të ri apo të rishikuar për marrje të dhënash apo të një vërtetimi statistikor që mbledh informacion që mund të jetë i dobishëm për palën tjetër në përmbushjen e detyrave të tyre ligjore.

9. MARRDHËNIET E RREGULLTA TË PUNËS

- (1) Palët nënshkruese të këtij Memorandumi zhvillojnë takime të rregullta tremujore dhe vjetore me drejtuesit e departamenteve të statistikave në institucione apo agjenci statistikore të tjera, si platformë e domosdoshme për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, për përmirësimin e

Memorandumi, kur është e nevojshme, me eksperiencën e krijuar gjatë zbatimit praktik të Programit. Si pasojë, palët marrin në konsideratë propozimet dhe sugjerimet e Grupit të Punës, siç parashikohet në Seksionin 4 të këtij Memorandumi.

- (2) Palët nënshkruese të këtij Memorandumi janë të ndërgjegjshme që funksionimi i Sistemit Kombëtar Statistikor nuk mund të arrihet plotësisht vetëm duke u bazuar nga detyrimet ligjore dhe zbatimi i rregullave. Me bindjen e të qenit partnerë dhe me synimin për të aritur një objektiv të përbashkët, palët inkurajojnë stafin e tyre të krijojnë procedura të ngushta bashkëpunimi edhe nëpërmjet një rrjeti joformal kontaktesh të përhershme pune, me qëllim që të përgatisin zgjidhje të përbashkëta të pranueshme në një nivel mundësisht sa më të ulët dhe sa më herët.

10. PËRMIRËSIMI I ANEKSIT

- (1) Udhëzime mbi standardet profesionale dhe të dhënat që do të shkëmbehen, duhet të përditësohen në përputhje me teknikat inovative elektronike si dhe praktikën e krijuar gjatë zbatimit të Programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare.
- (2) Kur është e nevojshme palët përshtasin aneksin duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e paraqitura nga Grupi i Punës sipas Seksionit 4 të këtij Memorandumi.

11. TË TJERA

- (1) Ky Memorandum lidhet për një kohë të pacaktuar dhe është subjekt i ndryshimeve vetëm me konsensusin e të dyja palëve.
- (2) Secila palë mund ta përfundojë Memorandumin duke lajmëruar me shkrim palën tjetër 30 ditë para.
- (3) Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, atëherë Memorandumi konsiderohet i përfunduar dhe i zgjidhur për të gjitha efektet.
- (4) Ky Memorandum hyn në fuqi dhe bëhet efektiv me nënshkrimin e tij nga përfaqësuesit e palëve.
- (5) Memorandumi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë.

**PËR
SHËRBIMIN KOMBËTAR TË
PUNËSIMIT**

ELIRA DEMIRAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

**PËR
INSTITUTIN E STATISTIKAVE**

DELINA IBRAHIMAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Shtojcë

Tabela A1: PUNËKËRKUES /TË PAPUNË

N r	Emertimi	gjendja në fund të muajit			sipas grupmoshave								sipas nivelit arsimor					
		gjithsej	femra	k/familjare	15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.	universitare
I	Punëkërkues të papunë gjithsej																	
Sipas grupeve të papunësisë																		
a	Pu Pa që përfitojnë pagesë papunesie																	
b	Pu Pa që përfitojne ndihmë ekonomike																	
c	Pu Pa të ish-ndihmës ekonomike																	
d	Punekërkues të papunë të tjerë																	
Grupe të veçanta punëkërkuesish të papunë																		
	Pu Pa afatgjatë gjithsej																	
	prej 1 - 3 vjetësh																	
	mbi 3 vjet																	
	Pu Pa romë apo egjiptian																	
	Pu Pa jetim																	
	Pu Pa viktimë të trafikut																	
	Pu Pa me aftësi të kufizuara																	
	Pu Pa emigrantë të kthyer																	
II	Punëkërkues																	

Tabela A2: PUNËKËRKUES TË PAPUNË QË PËRFITOJNË PAGESË PAPUNËSIE

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																

Tabela A3: PUNËKËRKUES TË PAPUNË QË PËRFITOJNË NDIHMË EKONOMIKE

SIPAS GRUPEVE SHKALLËSH TË FALËSISË QË TËRHIQTOJNË NDIHMË EKONOMIKE																	
	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPEVE SHKALLËSH TË FALËSISË QË TËRHIQTOJNË NDIHMË EKONOMIKE							SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																
	Nivel vendor																
	GJITHSEJ																

Tabela A4: PUNËKËRKUES TË PAPUNË TË TJERË

NËNDARJA		GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE						
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.	universitare
	Qarqet																	
	RRETHET																	
	Nivel vendor																	
GJITHSEJ																		

Tabela A5: PUNËKËRKUES TË PAPUNË AFATGJATË GJITHSEJ

ANALIZA E PËRVEKËRUES TË PAFALQËSIAVE GJITHSEJ																	
	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																
	Nivel vendor																
GJITHSEJ																	

Tabela A6: PUNËKËRKUES TË PAPUNË AFATGJATË 1-3 VJET

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergi.	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																
	Nivel vendor																
GJITHSEJ																	

Tabela A7: PUNËKËRKUES TË PAPUNË AFATGJATË MBI 3 VJET

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergi-	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																
	Nivel vendor																
GJITHSEJ																	

Tabela A8: PUNËKËRKUES TË PAPUNË ROMË DHE EGJIPTIAN

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																
	Nivel vendor																
GJITHSEJ																	

Tabela A9: PUNËKËRKUES TË PAPUNË JETIMË

Tabela A9: PUNEKERRKUES TE PAPUNEJETARE

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE								SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergi.	mesme prof.	universitare
	Qarqet																	
	RRETHET																	
	Nivel vendor																	
GJITHSEJ																		

Tabela A10: PUNËKËRKUES TË PAPUNË VIKTIMA TË TRAFIKUT

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE					
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																
	Nivel vendor																
GJITHSEJ																	

Tabela A11: PUNËKËRKUES TË PAPUNË ME AFTËSI TË KUFIZUARA

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							me pak se fillor	SHKALLA		ARSIMORE		
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50		mbi 50	fillor	9 vjeçar	mesme pergi.	mesme prof.
	Qarqet																
	RRETHET																
	Nivel vendor																
GJITHSEJ																	

Tabela A12: PUNËKËRKUES TË PAPUNË EMIGRANTË TË KTHYER

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE				
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.
	Qarqet															
	RRETHET															
	Nivel vendor															
GJITHSEJ																

Tabela A13: PUNËKËRKUES

	Nëndarja	GJITHSEJ	FEM.	KRYE/ FAMILJARE	SIPAS GRUPMOSHAVE							SHKALLA ARSIMORE							
					15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50	me pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesme pergj.	mesme prof.	universitare	
	Qarqet																		
	RRETHET																		
	Nivel vendor																		
GJITHSEJ																			

Tabela A14: Të dhëna për Pu.Pa që mbështeten me të ardhura

	Nëndarja	numri i PuPa te regjistruar	numri i PuPa nga ndihma ekonomike	ne % ndaj totalit	numri i PuPa nga pagesa e papunesie	ne % ndaj totalit
	Qarqet					
	RRETHET					
	Nivel vendor					
GJITHSEJ						

Tabela A15: BILANCI I PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË

		Që fitojnë pagesë	Në nivel vendor
Gjendja në fund të 6 muorit			
HYRJET	Gjithsej		
	që përfitojnë pagesë papunësie		
	që përfitojnë ndihmë ekonomike		
	të tjerë		
sipas arsyeve	a) Për herë të parë në ZP		
	- nga këta, pas përfundimit të shkollës		
	b) Të rikthyer në zyrën e punësimit pas:		
	- pasi ka humbur vendin e punës,		
	- pas përfundimit të programit të nxitjes së punësimit.		
	- pas refuzimit të shërbimeve/programeve,		
	- rikthehet për të kërkuar shërbime		
DALJET SIPAS GRUPEVE	gjithsej		
	që përfitojnë pagesë papunësie		
	që përfitojnë ndihmë ekonomike		
	të tjerë		
sipas arsyeve	Ndërmjetësim në punë,		
	Pjesëmarrje në Programet e Nxitjes së punësimit,		
	Gjeti punë vetë,		
	Refuzon shërbimin e ofruar,		
	Nuk kërkon më punë		
	Nuk u paraqit në Zyrën e Punësimit		
Gjendja në fund të 6 muorit			
Ndryshimi			

Specifikime për të dhënat e mësipërme:

Periodha kohore:

- Vjetore

Afati i dërgimit:

- Në tremujorin e parë të vitit N, të dërgohen të dhënat N-1

Specifikime të mëtejshme:

Tabela A16: NUMRI I PERSONAVE TË HUAJQË PUNOJNË NË SHQIPËRI SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË TYRE

Specifikimet për personat e huaj që punojnë në Shqipëri	Numri i individëve	Periodiciteti
sipas shtetësisë e individit	Numri i individëve	Vjetor
sipas aktivitetit ekonomik	Numri i individëve	Vjetor
sipas llojit të lejes	Numri i individëve	Vjetor
sipas punëmarrësit	Numri i individëve	Vjetor